

Vendim nr. 125 datë 05.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 05.06.2024, mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (R) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: RIDVAN BOZHO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1321, datë 25.05.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2023-4506, datë 02.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 43, 44, 49, 131, shkronja “f” dhe 134, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ridvan Bozho ka qenë punonjës pranë Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Sarandë me detyrë specialist logjistike. Ai është emëruar me urdhrin nr. 2976/1, datë 08.05.2012 të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve dhe në vijim marrëdhënia e tyre është formalizuar me kontratën individuale të punës të datës 14.05.2012.

2. Bazuar në raportin përfundimtar “Mbi auditimin e ushtruar në IEVP-në, Sarandë”, kjo e fundit i ka propozuar drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve marrjen e masës së largimit nga detyra ndaj kërkuesit. Ai është pezulluar nga detyra, por me shkresën nr. 5146/2, datë 02.08.2013 drejtori i përgjithshëm i Burgjeve ka urdhëruar që kërkuesi të rifillonte detyrën. Në vijim, me shkresën nr. 1124, datë 30.09.2013, IEVP-ja, Sarandë i ka propozuar drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve përsëri largimin nga detyra të kërkuesit, me arsyetimin se në raportin e auditimit evidentohen disa shkelje konkrete financiare gjatë ushtrimit të detyrës. Mbi këtë propozim, me urdhrin nr. 6690/1, datë 25.11.2013, drejtori i përgjithshëm i Burgjeve ka vendosur lirim të kërkuesit nga detyra.

3. Pas një ankese administrative, kërkuesi në datën 19.05.2014 i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, në objektin e së cilës ka kërkuar: i) anulimin e urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve për zgjidhjen e menjëhershme, të paarsyeshme dhe të pajustificuar të kontratës së punës dhe rikthimin në detyrën e mëparshme; ii) shpërblimin për pushimet e pamarrë për vitet 2012 dhe 2013; iii) pagimin e pagës për periudhën 01.06.2013 - 01.12.2013 bashkë me kamatëvonesat; iv) plotësimin e librezës së punës dhe librezës së kontributeve; v) dëmshpërblimin me 12 muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme; vi) dëmshpërblimin me 12 muaj pagë për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës; vii) dëmshpërblimin me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës të punës; viii) dëmshpërblimin me 1 muaj pagë për mosrespektim të afati të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; ix) zhdëmtimin e dëmit të pësuar për shkeljen e neneve 9, 10/1, 33, 38, 92, 93, 94, 95, 116/1, 119/1 dhe 120 të Kodit të Punës, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e pa shkaqe të arsyeshme të kontratës të punës; x) rimbursimin e shpenzimeve dhe dietave për shërbimet e kryera të punës; xi) shpërblimin e dëmit për shkeljen e nenit 17 të ligjit nr. 8503, datë 30.06.199 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”; xii) shpërblimin e dëmit jopasuror; xiii) pagimin e kontributeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi pagë për 6 muajt e vitit 2013; xiv) pagimin e gjobës në interes të buxhetit të shtetit, gjobës në masën 5% të totalit të kontributit të sigurimeve shoqërore të papaguara.

4. Me vendimin nr. 437, datë 30.06.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjrokastër ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke detyruar të paditurin, Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve, t'i paguajë paditësit (kërkuesit) dëmshpërblim me 21 paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës. Për pjesën tjetër të objektit të padisë gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit. Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar se kontrata e punës mes palëve është zgjidhur nga punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme, ndërsa nuk është respektuar afati dhe procedura sipas neneve 143 dhe 144 të Kodit të Punës. Kjo zgjidhje, sipas gjykatës, është e pajustificuar, pasi punëdhënësi nuk mundi të vërtetojë një shkak të justifikuar për zgjidhjen e kontratës së punës të tillë që nuk lejon sipas parimit të mirëbesimit vazhdimin e marrëdhënies së punës. Sipas saj, nga propozimi i IEVP-së, Sarandë për largimin nga detyra të paditësit, rezultojnë shkelje të lehta, ndërkohë që veprimet për keqadministrim të dokumentacionit nuk janë provuar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i padituri.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1321, datë 25.05.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Gjykata e apelit ka vlerësuar se vendimi i shkallës së parë është rrjedhojë e zbatimit jo të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat në gjykim. Sipas gjykatës së apelit, zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi është e menjëhershme, por e justifikuar, pasi është bërë për shkak të mospërmbushjes nga paditësi punëmarrës të detyrave të tij funksionale, ndërsa në gjykim provohen shkeljet financiare të lejuara nga ai dhe të konstatuara nga auditimi i kryer në IEVP-në, Sarandë, ku është evidentuar edhe dëmi ekonomik i shkaktuar. Për shkak se zgjidhja e kontratës së punës ka qenë e justifikuar, sipas gjykatës së apelit, punëmarrësi nuk gëzon të drejtën e dëmshpërblimit, përfshirë edhe atë për mosrespektimin e procedurës. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2023-4506, datë 02.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas Kolegjit Administrativ, në rekurs nuk ngrihen problematika që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material apo procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, dhe as nuk pretendohet se vendimi bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit

Administrativ apo të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po ashtu, në rekurs nuk parashtrohet ndonjë shkelje e rëndë e normave procedurale nga gjykata e apelit, ndërkohë që pretendimet e ngritura në lidhje me çështje të faktit nuk përfshihen në kompetencën funksionale të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 13.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të kërkesës, i cili pasi është plotësuar konform nenit 27, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë deformuar provat dhe faktet, pasi është fakt i njohur botërisht se IEVP-të nuk bëjnë tenderime, por vetëm magazinojnë dhe shpërndajnë mallra ushqimore, koloniale ose materiale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Për sa i përket përmblidhjes së këtyre kriterëve, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka

qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Kolegji vlerëson se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndërkohë që për pretendimet për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 02.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 13.03.2024. Ndërkohë, nga informacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë, rezulton se vendimi i kundërshtuar prej saj është bërë i disponueshëm për palët në faqen zyrtare në datën 22.12.2023. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pretendim i cili *prima facie* hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

16. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë deformuar provat dhe faktet, ndërsa është fakt i njohur botërisht se IEVP-të nuk bëjnë tenderime, por vetëm magazinonjë dhe shpërndajnë mallra ushqimore, koloniale ose materiale.

17. Neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 27, datë 27.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se ajo gjykatë krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e saj të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ndërkohë, Gjykata në mënyrë konstante ka theksuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e

zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre, nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, referuar praktikës dokumentare të paraqitur nga kërkuesi, Kolegji vëren se është ai që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor, me kërkesëpadi duke kërkuar anulimin e urdhrit për largimin e tij nga puna, rikthimin në punën e mëparshme dhe disa dëmshpërblime sipas Kodit të Punës. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka pranuar padinë pjesërisht, me arsyetimin se zgjidhja e kontratës së punës në rastin konkret është bërë nga punëdhënësi i paditur në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, pa u respektuar procedura për zgjidhjen e kontratës, duke akorduar në favor të kërkuesit dëmshpërblim në masën e 21 pagave mujore.

21. Në vijim, Kolegji vëren se mbi ankimin e të paditurit, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar padinë. Gjukata e apelit, mbi një analizë të ndryshme të provave, ka arritur në përfundimin se kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme nga punëdhënësi i paditur, por kjo zgjidhje ka qenë për shkaqe të arsyeshme, pikërisht për mospërmbushje të detyrave funksionale nga kërkuesi punëmarrës, ku mbi këtë bazë ka vlerësuar se ky i fundit nuk gëzon të drejtën e dëmshpërblimeve të akorduara nga gjykata e shkallës së parë.

22. Më tej, Kolegji vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, duke vlerësuar se në rekurs nuk ngrihen problematika në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit material apo procedural nga gjykatat më të ulëta dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, dhe as nuk pretendohet se vendimi i gjykatës së apelit bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ apo të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po ashtu, sipas atij kolegji, në rekurs nuk parashtrohet ndonjë shkelje e rëndë e normave procedurale nga gjykata e apelit, ndërkohë që për pretendimet e ngritura në rekurs në lidhje me

çështje të faktit, ai ka vlerësuar se ato nuk përfshihen në kompetencën funksionale të Gjykatës së Lartë.

23. Për sa më sipër, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si dhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i gjykatës së apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ajo, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo gjykatë është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykata e apelit ka vlerësuar provat dhe pretendimet e kërkuarit, por në analizë të tyre, si dhe të ligjit të zbatueshëm, ajo gjykatë ka arritur në përfundime jo të njëjta me kërkuarin. Po ashtu, edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuari është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Ky vendim nuk rezulton të jetë kontradiktor në përmbajtjen e tij.

24. Kolegji çmon të theksojë se interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme nuk janë çështje që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, për sa kohë nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuarit, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.